



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 9732 Prot

Lezhë, më 31 / 05 /2022

VENDIM

Nr. 53, Datë 31 . 05 .2022

PËR

DHËNIEN E PELQIMIT PËR LIDHJEN MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT
NDËRMJET FONDACIONIT “FIRDEUS” DHE BASHKISË LEZHË PËR
“NDËRTIMIN E SEKSIONIT 1, TË PALLATIT 71, (ISH BKT), NË LAGJEN
“BESËLIDHJA”, RRUGA “LUIGJ GURAKUQI”, TË QYTETIT TË LEZHËS”

Mbështetur në Ligjin 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", në Aktin Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, si dhe në Vendimin nr. 629, datë 29.7.2020 “Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondacionit “Firdeus”, për bashkëpunim në fushën e ndërtimit të banesave pas fatkeqësisë natyrore”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

VENDOSI :

1. Dhënie e pëlqimit për lidhjen e “Marrëveshjes së bashkëpunimit midis Fondacionit “Firdeus” dhe Bashkisë Lezhë për “Ndërtimin e seksionit 1, të Pallatit 71, (ish BKT), në Lagjen “Besëlidhja”, Rruga “Luigj Gurakuqi”, të Qytetit të Lezhës”.
2. Për lidhjen e marrëveshjes së bashkëpunimit dhe përcaktimin e detajave të saj autorizohet Kryetari i Bashkisë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
ERNEST RAKAJ

